**Republika e Kosovës**
**Republic of Kosovo - Republika Kosova**
***Qeveria- Government -Vlada***
***Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve***
***Ministarsvo Finansija, Rada i Trasfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers***

---

# PROJEKTLIGJI PËR MBËSHTETJEN E PUNËVE PUBLIKE

# DRAFT LAW ON SUPPORT OF PUBLIC WORKS

# NACRT ZAKONA O NAKNADI ZA PODRŠKU JAVNIH RADOVA

| | | |
|---|---|---|
| Kuvendi i Republikës së Kosovës, | Assembly of the Republic of Kosovo, | Skupština Republike Kosovo, |
| Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | In support of Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, | U skladu sa članom 65. (1) Ustava Republike Kosovo, |
| Miraton: | Approves: | Usvaja: |
| **PROJEKTLIGJI PËR KOMPENSIMIN PËR MBËSHTETJEN E PUNËVE PUBLIKE** | **DRAFT LAW ON COMPENSATION FOR THE SUPPORT OF PUBLIC WORKS** | **NACRT ZAKONA O NAKNADI ZA PODRŠKU JAVNIH RADOVA** |
| **KAPITULLI I**<br>**DISPOZITAT HYRËSE** | **CHAPTER I**<br>**INTRODUCTORY PROVISIONS** | **POGLAVLJE I**<br>**UVODNE ODREDBE** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**Purpose** | **Član 1.**<br>**Cilj** |
| Ky ligj ka për qëllim të krijojë një mekanizëm për kompensimin deri në një masë të caktuar të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore dhe punëve përcjellëse në kontratat për punë të lidhura në mes të Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë konform Ligjit përkatës për Prokurim Publik. | This law aims to create a mechanism for compensating up to a certain extent the increase in the prices of construction materials and follow-up works in contracts for works concluded between Contracting Authorities and Economic Operators in accordance with the relevant Law on Public Procurement. | Cilj ovog zakona je stvaranje mehanizma za naknadu do određene mere povećanja cene građevinskog materijala i pratećih radova u ugovorima o radu, zaključeni između Ugovornih organa i Ekonomskih operatera u skladu sa relevantnim Zakonom o javnim nabavkama. |
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2.**<br>**Polje delovanja** |
| Ky ligj zbatohet vetëm për kontratat aktive të punës të lidhura para datës 1 Prill 2022 | This law applies only to active employment contracts concluded before | Ovaj zakon se primenjuje samo na aktivne ugovore o radu zaključene pre |

| | | |
|---|---|---|
| konform procedurave të Ligjit përkatës për Prokurimin Publik. | 1st of April 2022 in accordance with the procedures of the relevant Law on Public Procurement. | 01. aprila 2022. godine, u skladu sa procedurama relevantnog Zakona o javnim nabavkama. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3.**<br>**Definicije** |
| 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet si në vijim: | 1. The expressions used in this law have the following meanings: | 1. Izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju sledeće značenje: |
| 1.1. **Çmimi Bazë** – Çmimi i një materiali ndërtimor siç është përcaktuar në kontratën e nënshkruar në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik. | 1.1. **Base Price** – The price of a construction material as defined in the contract signed between the Contracting Authority and the Economic Operator. | 1.1. **Osnovna Cena** – cena građevinskog materijala kao što je definisano u ugovoru potipisanom između Ugovornog organa i Ekonomskog operatera. |
| 1.2. **Çmimi i Tregut** – Çmimi i një materiali ndërtimor sipas vlerës aktuale në treg. | 1.2. **Market Price** – The price of a building material according to its current market value. | 1.2. **Tržišna Cena** – cena građevinskog materijala prema trenutnoj tržišnoj vrednosti. |
| 1.3. **Fatura Bazë** – Fatura e lëshuar nga Operatori Ekonomik e llogaritur me Çmime Bazë. | 1.3. **Basic Invoice** – Invoice issued by the Economic Operator calculated with Basic Prices. | 1.3. **Osnovni Račun** – račun koji izdaje Ekonomski operater obračunat sa osnovnim cenama. |
| 1.4. **Fatura e Kompensimit** – Fatura që lëshohet krahas Faturës Bazë dhe që përmban Kompensimin për Inflacion. | 1.4. **Compensation invoice** – Invoice issued alongside the Basic Invoice and that contains Inflation Compensation. | 1.4. **Račun za Naknadu** – račun koji se izdaje uz osnovni račun i sadrži naknadu za inflaciju. |
| 1.5. **Norma për Kompensim** – Përqindja e llogaritur nga Autoriteti Kontraktues sipas formularit të publikuar nga Ministria përkatëse për Financa për kërkesën e pranuar nga Operatori Ekonomik. | 1.5. **Compensation Rate** – The percentage calculated by the Contracting Authority according to the form published by the relevant Ministry of Finance for the request received by the Economic Operator. | 1.5. **Visina naknade** – procenat koji izračunava Ugovorni organ prema obrascu koje je objavilo Ministarstvo nadležno za finansije za primljen zahtev od Ekonomskog operatera. |

| | | |
|---|---|---|
| 1.6. **Kompensimi për Inflacion** – Shuma e përllogaritur nga Autoriteti Kontraktues kur shumëzon normën e kompensimit me vlerën e Faturës Bazë. | 1.6. **Compensation for Inflation** – The amount calculated by the Contracting Authority when multiplying the rate of compensation with the value of the Basic Invoice. | 1.6. **Naknada za Inflaciju -** iznos koji obračunava Ugovorni organ kada pomnoži stopu naknade sa vrednošću osnovnog računa. |
| 2. Të gjitha shprehjet e tjera të përdoruar në këtë Ligj kanë kuptimin sipas përkufizimeve të vendosura në Ligjin përkatës për Prokurim Publik dhe Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike. | 2. All other expressions used in this Law have the meaning according to the definitions established in the relevant Law on Public Procurement and the relevant Law on the Management of Public Finances. | 2. Svi ostali izrazi upotrebljeni u ovom Zakonu, imaju značenje prema definicijama utvrđenim u relevantnom Zakonu o javnim nabavkama i relevantnom Zakonu o upravljanju javnim finansijama. |
| **KAPITULLI II**<br>**MËNYRA E KOMPENSIMIT TË INFLACIONIT NË MATERIALE NDËRTIMORE** | **CHAPTER II**<br>**METHOD OF COMPENSATING INFLATION IN CONSTRUCTION MATERIALS** | **POGLAVLJE II**<br>**NAČIN NAKNADE ZA INFLACIJU U GRAĐEVINSKOM MATERIJALU** |
| **Neni 4**<br>**Materialet dhe punët përcjellëse për kompensim për inflacion** | **Article 4**<br>**Materials and accompanying works to compensate for inflation** | **Član 4**<br>**Naknada za inflaciju za materijal i prateće radove** |
| 1. Kompensimi për inflacion realizohet vetëm për materialet ndërtimore të cilat janë ndikuar nga inflacioni. Kjo listë e materialeve ndërtimore përfshin: | 1. Compensation for inflation is realized only for construction materials that have been affected by inflation. This list of construction materials includes: | 1. Naknada za inflaciju ostvaruje se samo za građevinske materijale koji su bili pogođeni inflacijom. Lista građevinskog materijala uključuje: |
| 1.1.Bitumin dhe emulzionin;<br>1.2.Çimenton;<br>1.3.Hekurin dhe produket e tij;<br>1.4.Plastikën dhe produktet e saj;<br>1.5.Betonin dhe produktet e tij; | 1.1.Bitumen and emulsion;<br>1.2.Cement;<br>1.3.Iron and its products;<br>1.4.Plastic and its products;<br>1.5.Concrete and its products; | 1.1.Bitumen i emulzija;<br>1.2.Cement;<br>1.3.Gvožđe i proizvodi od gvožđa;<br>1.4.Plastika i proizvodi od nje;<br>1.5.Beton i proizvodi od njega; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.6.Zhavorin;<br>1.7.Aluminin;<br>1.8.Bakrin; dhe<br>1.9.Zinkun. | 1.6.Gravel;<br>1.7.Aluminum;<br>1.8. Copper; and<br>1.9.Zinc. | 1.6.Šljunak;<br>1.7.Aluminijum;<br>1.8.Bakar; i<br>1.9.Cink. |
| 2. Kompensimi për inflacion realizohet edhe për punët përcjellëse si makineritë, fuqia punëtore dhe të tjera. | 2. Compensation for inflation is also realized for follow-up works such as machinery, labor force and others. | 2. Naknada za inflaciju se ostvaruje i za prateće radove kao što su mašinerija, radna snaga i dr. |
| **Neni 5**<br>**Kushtet dhe kufizimet për kompensimin për inflacion** | **Article 5**<br>**Conditions and limitations for compensation for inflation** | **Član 5.**<br>**Uslovi i ograničenja naknade za inflaciju** |
| 1. Të drejtë për të dorëzuar kërkesë për kompensim për inflacion kanë Operatorët Ekonomikë të cilët dëshmojnë se materialet ndërtimore, sipas paragrafit 1 të nenit 4, të cilat janë pjesë e kontratës së punës, kanë pësuar rritje të çmimeve. | 1. Economic Operators who prove that the construction materials, according to paragraph 1 of Article 4, which are part of the work contract, have experienced an increase in prices, are entitled to send a request for compensation for inflation. | 1. Ekonomski Operatori koji dokažu da je građevinski materijal, prema stavu 1. Člana 4. Koji je deo ugovora o delu, doživeo povećanje cena, imaju pravo da podnesu zahtev za naknadu inflacije. |
| 2. Ky ligj zbatohet vetëm për kontratat aktive të punës me vlerë të mesme dhe të mëdha të lidhura në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik. | 2. This law applies only to active work contracts of medium and large value concluded between the Contracting Authority and the Economic Operator. | 2. Ovaj zakon se primenjuje samo na aktivne ugovore o radu srednje i velike vrednosti zaključene između Ugovornog organa i Ekonomskog operatera. |
| 3. Ky ligj ka efekt vetëm për punët e certifikuara dhe faturat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik tek Autoriteti Kontraktues prej datës 1 Korrik 2022 deri më 30 Qershor 2023. | 3. This law is effective only for certified works and invoices submitted by the Economic Operator to the Contracting Authority from July 1, 2022, until June 30, 2023. | 3. Ovaj zakon važi samo za overene radove i račune koje je Ekonomski operater dostavio Ugovornom organu od 1. jula 2022. godine do 30. juna 2023. godine. |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Të gjitha kontratat e punës të cilat janë shkëputur dhe/ose janë subjekt i procedurave gjyqësore për anulim, ndryshim të çmimit apo të ngjashme, përjashtohen nga mundësia për kompensim për inflacion. | 4. All employment contracts which have been terminated and/or are subject to judicial proceedings for cancellation, price change or similar, are excluded from the possibility of compensation for inflation. | 4. Svi ugovori o radu koji su raskinuti i/ili su predmet sudskog postupka za raskidanje, promenu cene ili slično, su isključeni iz mogućnosti naknade zbog inflacije. |
| 5. Përjashtim nga paragrafi 4 i këtij neni përbëjnë Operatorët Ekonomikë të cilët mund të dëshmojnë që kanë tërhequr padinë pranë organeve gjyqësore apo arbitrazhi, dhe që kontrata është ende në fuqi. | 5. Exception from paragraph 4 of this article are the Economic Operators who can testify that they have withdrawn the lawsuit before the judicial or arbitration bodies, and that the contract is still in force. | 5. Izuzetak od stava 4. ovog člana su privredni subjekti koji mogu da svedoče da su povukli tužbu pred sudskim ili arbitražnim organima, i da je ugovor i dalje na snazi. |
| **Neni 6**<br>**Administrimi i kërkesave për kompensimin për inflacion** | **Article 6**<br>**Administration of inflation compensation claims** | **Član 6.**<br>**Upravljanje zahtevima za naknadu za inflaciju** |
| 1. Çdo Operator Ekonomik që pretendon se i plotëson kushtet, sipas nenit 5 të këtij Ligji, mund të dorëzojë kërkesë për kompensim për inflacion tek Autoriteti Kontraktues për punët që parashihen të përfundohen brenda afateve të përcaktuara sipas paragrafit 3 të nenit 5 të këtij Ligji. | 1. Any Economic Operator who claims to meet the conditions, according to Article 5 of this Law, may submit a request for compensation for inflation to the Contracting Authority for works that are expected to be completed within the deadlines set according to paragraph 3 of Article 5 of this Law. | 1. Svaki Ekonomski operater koji tvrdi da ispunjava uslove, prema članu 5. ovog zakona, može da podnese zahtev za naknadu zbog inflacije ugovornom organu za radove za koje se očekuje da će biti završeni u rokovima određenim prema stavu 3. čl. 5. ovog Zakona. |
| 2. Operatori Ekonomik së bashku me kërkesën dorëzon dokumente që dëshmojnë nevojën për kompensim për materialet përkatëse dhe çmimet e tregut për to. | 2. Together with the request, the Economic Operator submits documents proving the need for compensation for the relevant materials and their market prices. | 2. Ekonomski operater uz zahtev dostavlja dokumentaciju koja dokazuje potrebu za nadoknadom za relevantne materijale i njihove tržišne cene. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Autoriteti Kontraktues jo më larg se shtatë (7) ditë kalendarike nga pranimi i kërkesës, nxjerr vendimin aprovues, vendim aprovues me ndryshime ose refuzues lidhur me kërkesën për kompensim për inflacion. | 3. The Contracting Authority, no later than seven (7) calendar days from the receipt of the request, issues the approving, approving with changes or rejecting decision regarding the request for compensation for inflation. | 3. Ugovorni organ najkasnije u roku od sedam (7) kalendarskih dana od prijema zahteva, donosi odluku o odobrenju, odobrenje sa izmenama, ili odbijanju zahteva za naknadu za inflaciju. |
| 4. Vendimi aprovues përmban normën për kompensim sipas kërkesës nga Operatori Ekonomik, vendimi aprovues me ndryshim përmban normën për kompensim sipas ndryshimeve të bëra nga Autoriteti Kontraktues gjatë shqyrtimit të kërkesës, kurse vendimi refuzues përmban arsyet për refuzim. | 4. The approval decision contains the rate for compensation according to the request of the Economic Operator, the approval decision with changes contains the rate for compensation as per the changes made by the Contracting Authority while reviewing the request, whereas the rejection decision contains the reasons for rejection. | 4. Odluka o odobrenju sadrži stopu naknade prema zahtevu ekonomskog operatera, odluka o odobrenju sa izmenama sadrži stopu naknade prema izmenama koje je ugovorni autoritet izvršio prilikom razmatranja zahteva, dok odluka o odbijanju sadrži razloge za odbijanje. |
| 5. Vendimet nga paragrafi 3 të këtij neni, mund të dorëzohen për rishqyrtim nga ana e Operatorit Ekonomik tek Autoriteti Kontraktues brenda pesë (5) ditëve kalendarike. | 5. Decisions from paragraph 3 of this article can be submitted for reconsideration by the Economic Operator to the Contracting Authority within five (5) calendar days. | 5. Odluke iz stava 3. ovog člana mogu biti podnete na ponovno razmatranje od strane ekonomskog operatera ugovornom organu u roku od pet (5) kalendarskih dana. |
| 6. Në rastin e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike e nxjerr vendimin përfundimtar mbi çështjen e kompensimit për inflacion. | 6. In the case of the submission of the request for reconsideration, the Contracting Authority issues the final decision on the issue of compensation for inflation within ten (10) calendar days. | 6. U slučaju podnošenja zahteva za ponovno razmatranje, Ugovorni organ donosi konačnu odluku o pitanju naknade za inflaciju u roku od deset (10) kalendarskih dana. |
| 7. Në rast se Operatori Ekonomik nuk pajtohet me vendimin përfundimtar të | 7. In case the Economic Operator does not agree with the final decision of the | 7. U slučaju da se Ekonomski operater ne slaže sa konačnom odlukom |

| | | |
|---|---|---|
| Autoritetit Kontraktues, sipas paragrafit 6 të këtij neni, atëherë Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shkëpusë kontratën e punës me Operatorin Ekonomik dhe të ekzekutojë sigurimin sipas kontratës. | Contracting Authority, according to paragraph 6 of this article, then the Contracting Authority has the right to terminate the employment contract with the Economic Operator and execute the insurance according to the contract | Ugovornog organa, prema stavu 6. ovog člana, Ugovorni organ ima pravo da raskine ugovor o radu sa Ekonomskim operaterom i izvrši osiguranje po ugovoru. |
| **Neni 7**<br>**Raportimi dhe monitorimi i vendimeve** | **Article 7**<br>**Reporting and monitoring of decisions** | **Član 7.**<br>**Izveštavanje i praćenje odluka** |
| 1. Çdo javë, Autoriteti Kontraktues njofton Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për kontratat e punës për të cilat, gjatë asaj jave, ka pranuar kërkesa për kompensim për inflacion sipas paragrafi 1 të nenit 6 të këtij Ligji. | 1. Every week, the Contracting Authority notifies the Public Procurement Regulatory Commission for the work contracts of which, during that week, it has received requests for compensation for inflation according to paragraph 1 of article 5 of this Law. | 1. Naručilac svake sedmice obavještava Regulatornu komisiju za javne nabavke o ugovorima o radu za koje je tokom te sedmice primio zahtjeve za naknadu inflacije u skladu sa stavom 1. člana 5. ovog zakona. |
| 2. Brenda tre (3) dite kalendarike pas nxjerrës së vendimit për aprovim ose refuzim të kërkesës për kompensim për inflacion, Autoritetet Kontraktuese i vendosin të gjitha vendimet në platformën elektronike të prokurimit publik. Çdo kërkesë për pagesë për kompensim për inflacion pa e respektuar këtë paragraf konsiderohet si e pavlefshme. | 2. Within three (3) calendar days after issuing the decision to approve or reject the request for compensation for inflation, the Contracting Authorities place all decisions on the public procurement electronic platform. Any claim for payment of inflation compensation without complying with this paragraph shall be deemed invalid. | 2. U roku od tri (3) kalendarska dana nakon donošenja odluke o odobrenju ili odbijanju zahteva za naknadu za inflaciju, Ugovorni organi objavljuju sve odluke na elektronsku platformu javnih nabavki. Svaki zahtev za isplatu naknade za inflaciju bez poštovanja ovog stava smatraće se nevažećim. |
| 3. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik monitoron nëse të gjitha vendimet për kompensim për inflacion | 3. The Public Procurement Regulatory Commission monitors whether all inflation compensation decisions are | 3. Regulatorna komisija za javne nabavke prati da li su sve odluke o naknadi za inflaciju priložene u elektronski sistem nabavki. |

| | | |
|---|---|---|
| janë të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik. | uploaded to the electronic procurement system. | |
| 4. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik përpilon raporte periodike çdo muaj mbi të dhënat e gjeneruara dhe evidentuara nga vendimet për kompensim për inflacion përmes platformës elektronike të prokurimit. Për qëllime informimi, raportet e tilla dorëzohen tek Ministria përgjegjëse për Financa. | 4. Public Procurement Regulatory Commission compiles periodic reports every month on the data generated and evidenced by decisions on compensation for inflation through the electronic procurement platform. For information purposes, such reports are submitted to the Ministry responsible for Finance. | 4. Regulatorna komisija za javne nabavke svakog meseca izrađuje periodične izveštaje o prikupljenim i evidentiranim podacima na osnovu odluka o naknadi za inflaciju putem elektronske platforme za nabavku. Radi informisanja, takvi izveštaji se dostavljaju relevantnom Ministarstvu finansija. |
| **Neni 8**<br>**Përllogaritja e kompensimit për inflacion** | **Article 8**<br>**Calculation of compensation for inflation** | **Član 8.**<br>**Obračun naknade za inflaciju** |
| 1. Ministria përgjegjëse për Financa publikon formularin me formulë përkatëse në bazë të së cilit përllogaritet norma për kompensim. Ky formular publikohet brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij Ligji. | 1. The Ministry responsible for Finance publishes the form with the corresponding formula based on which the compensation rate is calculated. This form is published within seven (7) calendar days from the entry into force of this Law. | 1. Odgovorno Ministarstvo za finansije objavljuje obrazac sa odgovarajućom formulom na osnovu koje se obračunava visina naknade. Ovaj obrazac se objavljuje u roku od sedam (7) kalendarskih dana od stupanja na snagu ovog zakona. |
| 2. Formula përmban pozicione të caktuara për secilin material ndërtimor dhe një pozicion për punët përcjellëse ku përmes peshës së secilit pozicion, peshës së tyre në kontratën e punës, dhe çmimit bazë e çmimit të tregut për to përcaktohet norma për kompensim. | 2. The formula contains certain positions for each construction material and a position for follow-up works where the rate for compensation is determined through the weight of each position, their weight in the employment contract, and the base price of their market price. | 2. Formula sadrži određene pozicije za svaki građevinski materijal i poziciju za prateće radove pri čemu se kroz težine svake pozicije, njihove težine ugovorom o radu, i osnovne tržišne cene određuje visina naknade. |

| | | |
|---|---|---|
| 3. Autoriteti Kontraktues i vendos të dhënat sipas kërkesës së Operatorit Ekonomik në formularin sipas paragrafit 2 të këtij neni, dhe nxjerr normën e kompensimit për atë kërkesë. | 3. The Contracting Authority places the data at the request of the Economic Operator in the form according to paragraph 2 of this article, and issues the compensation rate for that request. | 3. Ugovorni organ objavljuje podatke na osnovu zahteva Ekonomskog operatera, u obrascu prema stavu 2 ovog člana, i izdaje visinu naknade za taj zahtev. |
| 4. Përqindja maksimale e kompensimit për punët përcjellëse, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji, nuk mund të kalojë vlerën e inflacionit sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Agjencia përkatëse për Statistika. | 4. The maximum percentage of compensation for follow-up work, according to paragraph 2 of article 4 of this Law, cannot exceed the value of inflation according to the Harmonized Index of Consumer Prices published by the relevant Agency for Statistics. | 4. Maksimalni procenat naknade za prateći rad, shodno stavu 2. člana 4. ovog zakona, ne može biti veći od vrednosti inflacije prema Harmonizovanom indeksu potrošačkih cena koji objavljuje nadležna Agencija za statistiku. |
| 5. Pavarësisht normës për kompensim të përcaktuar sipas formularit, norma për kompensim nuk mund të kalojë njëzetë për qind (20%) të vlerës totale të faturës bazë. | 5. Regardless of the compensation rate determined according to the form, the compensation rate cannot exceed twenty percent (20%) of the total value of the basic invoice. | 5. Bez obzira na visinu naknade utvrđene prema obrascu, visina naknade ne može biti veća od dvadeset posto (20%) od ukupne vrednosti osnovne fakture. |
| **Neni 9**<br>**Menaxhimi i faturave** | **Article 9**<br>**Invoice management** | **Član 9.**<br>**Upravljanje računima** |
| Operatori Ekonomik për të gjitha punët e ceritifkuara dorëzon tek Autoriteti Kontraktues faturën bazë dhe faturën e kompensimit. | The Economic Operator for all certified works submits the basic invoice and the compensation invoice to the Contracting Authority. | Ekonomski operater za sve overene radove, Ugovornom organu dostavlja osnovni račun i račun za naknadu. |
| **KAPITULLI III**<br>**ZBATIMI, MONITORIMI DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE** | **CHAPTER III**<br>**IMPLEMENTATION, MONITORING AND FINAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE III**<br>**SPROVOĐENJE, PRAĆENJE I ZAVRŠNE ODREDBE** |

| Neni 10<br>Regjistrimi dhe raportimi i shpenzimeve | Article 10<br>Recording and reporting of expenses | Član 10<br>Evidentiranje i prijavljivanje troškova |
|---|---|---|
| 1. Ministria përgjegjëse për Financa, përcakton një kod ekonomik të dedikuar në kuadër të planit kontabël, me qëllim të regjistrimit dhe raportimit të shpenzimeve shtesë të krijuara nga kompensimi për inflacion. | 1. The Ministry responsible for Finance defines a dedicated economic code within the accounting plan, in order to record and report additional expenses created by compensation for inflation. | 1. Ministarstvo nadležno za finansije u okviru računovodstvenog plana određuje poseban ekonomski kod, radi evidentiranja i prijavljivanja dodatnih troškova nastalih kompenzacijom za inflaciju. |
| 2. Autoriteti Kontraktues realizon procesin e shpenzimit të faturës së kompensimit, nga ndarjet aktuale buxhetore të projektit, në kodin përkatës ekonomik, sipas paragrafit 1 të këtij neni. | 2. The Contracting Authority carries out the process of spending the compensation invoice, from the current budget allocations of the project, in the relevant economic code, according to paragraph 1 of this article. | 2. Ugovorni organ sprovodi proces trošenja računa za naknadu, iz tekućih budžetskih izdvajanja projekta, u relevantnom ekonomskom kodu, prema stavu 1. ovog člana. |
| 3. Zyra Kombëtare e Auditimit, në pajtim me mandatin ligjor, i vendos fokus në planin e auditimit shpenzimeve të krijuara në kodin ekonomik të dedikuar për qëllime të këtij Ligji. | 3. The National Audit Office, in accordance with the legal mandate, places focus in the audit plan on the expenses created in the economic code dedicated to the purposes of this Law. | 3. Nacionalna kancelarija za reviziju, u skladu sa zakonskim mandatom, stavlja fokus na plan revizije na troškove stvorene u ekonomskom kodu koji je namenjen za svrhe ovog Zakona. |
| **Neni 11<br>Të drejtat dhe detyrimet e pa-afektuara** | **Article 11<br>Rights and unaffected obligations** | **Član 11<br>Prava i obaveze bez uticaja** |
| Kompensimi për inflacion nuk i afekton të drejtat dhe detyrimet e tjera kontraktuale të | Compensation for inflation does not affect other contractual rights and obligations concluded between the | Naknada za inflaciju ne utiče na druga ugovorna prava i obaveze između Ugovornog organa i Ekonomskog operatera. |

| | | |
|---|---|---|
| lidhura ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik. | Contracting Authority and the Economic Operator. | |
| **Neni 12**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 12**<br>**Entry into force** | **Član 12.**<br>**Stpanje na snagu** |
| Ky ligj hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare dhe është në fuqi deri më 30 Qershor 2023. | This law enters into force after publication in the Official Gazette and is in force until June, 30 2023. | Ovaj zakon stupa na snagu nakon objavljivanja u Službenom glasniku i na snazi je do 30. juna 2023. godine. |
| **Glauk KONJUFCA**<br>___________________<br>**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës** | **Glauk KONJUFCA**<br>___________________<br>**President of the Assembly of Republic of Kosovo** | **Glauk KONJUFCA**<br>____________________________<br>**Predsednik Skupštine Republike Kosovo** |
| Datë: ____/_____/________ | Date: ____/_____/________ | Dana: ____/_____/________ |